

VETËDIJA KRITIKE E ARSHI PIPËS

Jehona SHALA

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Kritika letrare shqipe, në historinë e zhvillimit të vet, ka pranuar e refuzuar format e zhvillimit të kritikës letrare në një trajektore atipike krahasuar me kritikën letrare në vendet perëndimore. Ky zhvillim i kritikës letrare shqipe ka bërë që historia e kritikës së letërsisë shqipe sot të na ofrojë njohje mbi tipa të ndryshëm të kritikës: kritikën pozitiviste, kritikën psikanalitike, kritikën fenomenologjike, kritikën sociologjike etj. Të gjitha këto përfaqësohen me emra të dallueshëm autorësh dhe me markimin e tyre në kulturën e studimit të artit letrar. Ky markim e përcjell edhe autorin Arshi Pipa, i cili me veprën e tij studimore “*Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*” riktheu debatin për studimet sociologjike në letërsinë shqipe, edhe pse publikut shqiptar kjo vepër iu prezantua vonë, disa dekada pas publikimit në gjuhën angleze.

Fjalë çelësa: Historia e kritikës letrare shqipe, kritika pozitiviste, kritika psikanalitike, kritika sociologjike, Arshi Pipa.

I. Kritika letrare shqipe

Kritika letrare, e quajtur shpesh *bijë e veprës letrare*¹, është *zbulesë e modernitetit*². Kjo zbuluesë në letrat shqipe shpërfaqë studimet e para të

¹ Sabri Hamiti, *Kritika Letrare*, “Faik Konica”, Prishtinë 2002, f. 45.

² Për konceptet e *zbulesës dhe modernitetit*, shih: Kujtim Shala, *Zbulesa e Modernitetit* (Ontos-i, poetika e kritika), Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë 2017, f. 47-48.

veprës letrare shqipe me Faik Konicën. Duke qenë prijësi, Konica bashkë me shkrimet e para kritike për veprën letrare shqiptare dha edhe mendimet e para mbi kritikën si *mësim*³, duke na treguar se ajo *është një gjykim – një gjykim i vlerës së librit*⁴. Pra, kritika është gjykim mbi veprën letrare, e gjykimi varet nga vlera letrare e veprës, e cila është e matshme me dijen e kritikut, prandaj *s'duhet kurrë harruar që kritika letrare është subjektive. Nuk është gjuhë shkence ku çdo e thënë mund të provohet me dy e dy bëjnë katër*⁵. Duke e provuar veten si *subjektivitet kulturor, përkrah veprës narrative si subjekt letrar*,⁶ Konica dëshmon që s'e do veprën letrare si objekt, studimi i së cilës duhet t'i nënshtrohet metodës shkencore matematikore, por pëlqen të komunikojë me të dhe këtë komunikim t'ia prezantojë përpara lexuesit. Ky model i Konicës u përcoll në pjesën më të madhe të kritikës shqipe. Kësisoj, edhe kur u tentua kritika objektive, nuk u tejkalua pothuajse asnjëherë subjektiviteti kulturor i kritikut, pavarësisht preferencës metodologjike.

Kështu historia e kritikës shqipe pas Konicës njihet me kritikën introductive të Nolit - kritikë *me premisa etike e sociologjike*⁷; kritikën psikanalitike të Krist Malokit, i cili edhe pse këmbëngul për kritikë *serioze e objektive*⁸, te studimi mbi Naimin shprehet se *këtu duhet ma tepër ndiesië sesa dije, ma tepër zemër sesa tru...*⁹; vjen pastaj Eqrem Çabej, që fenomenin letrar provon ta trajtojë nga prizmi kulturo-historik, e Mitrush Kuteli që anon kah analiza letrare me theks formal¹⁰. Pas një periudhe prej afro gjysmë shekulli, kritika letrare shqipe e përfaqësuar nga Konica, Noli, Maloki, Çabej e Kuteli u pasua nga kritika e re, e cila u zhvillua në një kontekst të ri shoqëror, politik e kulturor. Ndryshimet socio-kulturore e ndryshuan edhe qasjen ndaj letërsisë. Derisa në Kosovë kritika letrare i kërkonte modelet e saj në kritikën perëndimore, kritika letrare e Shqipërisë orientohej kah modelet lindore. Në Kosovë, në fushën e kritikës, shquhen veçanërisht studimet e Rexhep Qosjes, Ibrahim

³ Po aty, f. 48.

⁴ Ibrahim Rugova dhe Sabri Hamiti, *Kritika letrare*, Rilindja, Prishtinë 1979, f. 69.

⁵ Faik Konica, "Kohëtore e letrave shqipe", Albania, Viti 10, nr 5, (1906), f. 100.

⁶ Po aty, f. 48.

⁷ Ibrahim Rugova, *Kahe dhe Premisa të Kritikës letrare shqiptare: 1504-1983*. "Faik Konica", Prishtinë 2005, f. 307.

⁸ Krist Maloki, *Refleksione: Kritikë (letrare), analiza dhe mendime*, "Faik Konica", Prishtinë 2005, f. 15.

⁹ Krist Maloki, vep. e cit. f. 34.

¹⁰ Ibrahim Rugova, vep. e cit., f. 306.

Rugovës, Sabri Hamitit, Mensur Raifit, Bajram Krasniqit, Ramadan Muliut etj., të cilët u bënë markë e studimeve secili me veçantinë e tyre, duke shënjuar kështu me emra të përveçëm metoda e modele. Qosja zhvilloi kritikën integrale, Rugova *shënjon e lexon fenomene letrare e kulturore* me fokus në *analizën e tekstit e leximin semiotik*¹¹, Hamiti, ngjashëm me Konicën, e provon subjektivitetin e tij kulturor në veprat letrare, duke shënjuar fenomenet letrare e kulturore, ndërkaq Raifi shkruan kritikën psikanalitike. Në Shqipëri, kritika letrare - që me Dhimiter Shuteriqin e Arshi Pipën *kishte pranuar pikëpamjet sociologjike e ideologjike të letërsisë*¹² - nisi si kritikë sociologjike dhe, me kohë, Shuteriqi dhe pasuesit e tij e pranuan dhe promovuan kritikën e realizmit socialist. Kurse Arshi Pipa, i cili vazhdoi ta shkruajë kritikën letrare jashtë Shqipërisë, mbeti pothuajse i vetmi studiues që në studimet letrare aplikoi qasjen sociologjike.

Dallimi mes kritikës që nisi si sociologjike dhe që morri nuanca të theksuara të metodës së realizmit socialist nga Shuteriqi dhe pasuesit e tij, e që mbështetej në tipin e socializmit sovjetik ku ishte proklamuar e pranuar kjo teori¹³ dhe kritikës sociologjike të Pipës konsiston në faktin se kritika e realizmit socialist e shkruar në Shqipëri për afro gjysmë shekulli u bë pjesë e pandashme e pikëpamjeve politike e ideologjike të kohës. Si rezultat i kësaj, ky tip kritike humbi sensin e subjektivitetin dhe në këtë rast humbja e subjektivitetit nuk nënkupton kritikën e pastër shkencore, por humbjen e subjektivitetit individual përballë trajtimit të tekstit letrar si materie shqyrtimi. Nga subjektiviteti individual, që e dominonte kritikën shqipe në origjinë, kritika u konstruktua sipas pikëpamjeve e bindjeve ideologjike të prijësit politik, ideologjia e të cilit u bë normë për institucionin e kritikës. Për dallim nga e para, kritika sociologjike e Pipës ishte një formë e qasjes studimore ndaj letërsisë, qasje që u zhvillua për një kohë të gjatë në qarqet kulturore e letrare perëndimore nga studiues të cilët mendonin e besonin se letërsia është pasqyrim shoqëror. Qasja sociologjike ndaj letërsisë ruajti subjektivitetin e kritikut, në rastin e Pipës, por gjithashtu kjo qasje, shikuar në diakroni, zhvilloi pikëpamje të ndryshme mbi raportin mes letërsisë e shoqërisë, por që në esencë e ruajti mendimin se letërsia është produkt social.

¹¹ Kujtim Shala, vep. e cit., f. 51.

¹² Po aty, f. 307.

¹³ Ibrahim Rugova, vep. e cit., f. 201.

II. Teoria dhe kritika sociologjike

I pari studiuës që trajtoi sistematikisht relacionin në mes shoqërisë dhe letërsisë është filozofi dhe kritiku frëng Hippolyte Taine. Taine nuk është sigurisht i pari që e ngriti diskutimin mbi implikimet shoqërore në artin imagjativ, sepse kjo del qysh te koncepti i Platonit mbi imitim, i cili letërsinë e sheh si pasqyrim shoqëror¹⁴, por është i pari studiuës i cili mendimin se letërsia është produkt shoqëror e shndërroi në teori dhe me të drejtë konsiderohet si themelues i shkencës shoqërore në letërsi¹⁵. Formula e tij “raca, mjedisi, momenti” u bë formulë e interpretueshme, po aq sa e keqinterpretueshme¹⁶. Këto tri elemente kryesisht nënkuptuan tri pika kyçe të cilave letërsia nuk mund t’u shmangej – apo, edhe më saktë, tre përbërës esenciale të cilët e përbëjnë brumin letrar, sipas Taines. Raca shihet si *lidhje midis tipareve fizike dhe zakoneve specifike mendore*; Mjedis i nënkupton kushtet politike dhe sociologjike, ndërsa momenti shpesh duket si *shuma e përbashkët e racës dhe mjedisit, ose impuls i fituar nga një situatë konkrete historike*¹⁷. Kështu, për Tainen, veprat letrare janë monumente kombëtare, sepse ato përfaqësojnë *vetëdijen shoqërore dhe frymën e epokës*.¹⁸ Për filozofin gjerman Jonathan Herder secila vepër letrare është e rrënjësuar në një mjedis të caktuar shoqëror dhe gjeografik¹⁹. Pasuese e ideve të Herderit është Madam De Stal, e cila jo vetëm letërsinë në përgjithësi e sheh si produkt të shoqërisë, por edhe një formë e caktuar letrare për të është e kushtëzuar nga rrethanat shoqërore. Pra, janë këta tre autorë të cilët insistuan që letërsia duhet vështruar nga themelet e shoqërisë²⁰.

Një qasje e re sociologjike letrare shfaqet me studiuësin gjermano-hebre Leo Lowenthal, nga Shkolla e Frankfurtit, i cili pranon se *letërsia përcejell shumë nivele kuptimi, disa të synuara nga autori, disa krejt të*

¹⁴ Diana T. Laurenson, dhe Alan Swingewood, *The Sociology of Literature*, Schocken Books, New York 1972, f. 23.

¹⁵ Rene Wellek, *A history of modern criticism: 1750-1950: The later nineteenth century*. (New Haven and London: Yale University Press, 1965). f. 23.

¹⁶ “Raca” u keqinterpretua dhe u keqpërdor veçanërisht nga nazistët, të cilët këtë element e përdorën për nevojat ideologjike të tyre. Për më tepër, shih Rene Wellek, *A history of modern criticism*, fq. 27-57.

¹⁷ Wellek, Rene. Vep e cit., f. 27.

¹⁸ Diana T. Laurenson, dhe Alan Swingewood, *The Sociology of Literature*, Schocken Books, New York 1972, f. 24-25.

¹⁹ Po aty, f. 26.

²⁰ Po aty, f. 32.

paqëllimta. Një autor vendosë të shpikë një komplot, për të përshkruar veprimin, për të përshkruar marrëdhëniet e ndërlidhura të personazheve, për të theksuar vlera të caktuara... është detyrë e sociologut të letërsisë ta lidhë përvojën e personazheve dhe situatave imagjinare të shkrimit me klimën historike nga e cila rrjedh²¹. Nga kjo kuptojmë se Lowenthal nuk insiston në rrënjët sociologjike të letërsisë, por e pranon studimin sociologjik letrar si një mënyrë studimi, përcaktimi i shëmbëllimeve sociologjike i së cilës (veprës) nuk nënkupton detyrimisht që letërsia është në total përngjasim shoqëror, por përmban elemente shoqërore.

Keneth Burke, edhe pse ishte njëri nga themeluesit e Kritikës së Re, te studimi *Letërsia si pajisje për jetesë*, i rikthehet studimit sociologjik të letërsisë, duke pranuar se kjo qasje studimi është e vjetër, por që ka vend ende për elemente të reja. E reja për Burke, nisur nga shembulli i proverbave, është strategjia – më saktë strategjia e proverbave për trajtimin e situatave. Nëse proverbat i takojnë taborit të letërsisë, situatat i përkasin vetëm jetës reale. Dhe hetimi i strategjive përfshin raportin e veprës me kohën e shkrimit dhe qëllimin e saj në raport me kontekstin real jetësor. Në lidhje me këtë, ky autor do të shprehet: *natyrisht më e sofistikuar dhe më e çmuara vepër e artit, rritur në gjirin e civilizimeve komplekse, mund të quhet si e dizajnuar për të organizuar dhe diktuar morinë e mendimeve dhe imazheve dhe njëherazi organizimin e tyre në mënyrë të atillë që “ia imponon armikut kohën dhe vendin si dhe kushtet për luftën e zgjedhur vetë”. Njëri mëton “të drejtojë lëvizjet dhe veprimet e mëdha” në ekspeditën e jetesës së tjetrit. Njëri “manovron” dhe manovrimi është “art”²². Nëse civilizimet komplekse mund t’i përkthejmë si shoqëri që në momente të caktuara kanë përjetuar fazën e transformimeve të mëdha shoqërore, në këto transformime ka marrë pjesë edhe letërsia si diktat për orientime të caktuara. Dhe strategjia mund të konsiderohet e realizuar nëse lexuesi e ka pranuar dhe respektuar si të tillë. Në marrëdhënien letërsi-lexues dhe në ndikimet e anasjella në planin e gjerë shoqëror, u bazuan edhe mendimet e sociologut të letërsisë Robert Escarpit. Për të *asnjë sociologji e letërsisë nuk është e mundur pa sociologjinë e leximit dhe të konsumit kulturor në përgjithësi*.²³ Këto janë*

²¹ Leo Lowenthal, *Literature and the image of man*, Beacon Press, Boston 1957, f. X.

²² Keneth Burke, *Literature as Equipment for Living* në *Critical Theory Since Plato*, Peking University Press, Pekin 2006, f. 1013.

²³ Arun Murlidhar Jadhav, *The Historical Development of the Sociological Approach to the Study of Literature*, *International Journal of Innovative Research & Development*. Vol 3 Issue 5 (2014), f. 661.

vetëm disa nga qasjet e studimit sociologjik në historinë e studimeve sociologjike letrare. Në këto modele duket se u bazua edhe Arshi Pipa në studimin *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*.

III. Letërsia shqipe dhe kritika sociologjike - Arshi Pipa

*Dijet dhe kultura filozofike që kishte marrë në Universitetin e Firencës ia kishin bërë atij të mundshme që në studimet letrare të adoptonte kënde vështrimi pak më të veçanta ndër studiuesit shqiptarë.*²⁴ Dhe pikërisht këto kënde vështrimi të tij u shfaqën në trajtimin sociologjik të letërsisë shqipe, duke e ranguar atë si të vetmin studiues që provon teorinë e kritikës sociologjike në dy kapitujt e parë të librit *Letërsia shqipe: perspektiva sociale* dhe kritikën sociologjike, si praktikë studimi, në kapitullin tre e katër të po këtij libri.

Pipa e shpall qasjen sociologjike ndaj letërsisë shqipe qysh në parathënie të librit, i vetëdijshëm se mungon një qasje e tillë. Për Pipën, pikërisht letërsia shqipe duhet të shikohet nga prizmi sociologjik, meqenëqë ajo kryesisht është produkt i folklorit - një shkencë shoqërore.²⁵

Kalimi i letërsisë shqipe nga letërsia popullore në letërsi të kultivuar artistike u bë jashtë trojeve shqiptare, në Itali, nga arbëreshët që migruan atje si rezultat i zhvillimeve shoqërore e politike. Këtë fenomen shoqëror e kulturor Pipa e argumenton me nevojën e arbëreshëve për ruajtjen e traditës kulturore e fetare në oazën që ndërtuan në një vend të huaj. Arbëreshët e ikur nga Shqipëria nuk u shkëputën nga lidhjet e tyre me traditën kulturore, fetare e etnike. Kjo ndërlidhje dhe shenjat e saj në letërsinë arbëreshe trajtohen në kapitullin *Ethosi dhe Ethnosi në traditën letrare arbëreshe*. Kapitulli përmban të dhëna të detajuara mbi kulturën, historinë dhe shtrirjen gjeografike të arbëreshëve në Itali, komponentë që për Pipën janë shpirti i letërsisë arbëreshe. Në tentativë për të krijuar një pamje më të qartë mbi këtë letërsi, lidhjen e saj me folklorin, nevojën për ruajtjen e këtij të fundit si shenjë e veçantë e *ethosit* dhe *ethnosit* shqiptar, Pipa prezanton historinë kulturore, fetare, shoqërore e gjuhësore, si përbërës që ndikuan drejtpërdrejt në kahen e letërsisë arbëreshe. Për ta argumentuar ndikimin e letërsisë popullore në letërsinë arbëreshe dhe bartjen e shenjave kulturore e nacionale në këtë të fundit, Pipa analizon

²⁴ Rexhep Ismajli, *Arshi Pipa: Ftesë për lexim*. MM: revistë mikste teorike dhe letrare, nr. 6-7 (1997), f. 173.

²⁵ Arshi Pipa, *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Princi, Tiranë 2013, f. 7.

hollësisht veprën e De Radës. Analiza që Pipa i bën letërsisë së De Radës është interesante për së paku dy arsye: e para është identifikimi historik i temave letrare dhe personazheve në veprën e tij dhe e dyta është kërkimi i sfondit gjeografik në veprën e tij. Te temat dhe personazhet që ndërli-dhen me historinë, Pipa analizon në detaje çdo personazh që nga origjina e emrave e deri të lidhjet direkte jashtëletrare të De Radës me figurat letrare që e intrigojnë apo me personat që e rrethonin, duke i kthyer kë-shtu personat me ndikim historik dhe personat realë në personazhe let-rare. Kurse në kërkimin e sfondit gjeografik, Pipa këtë kërkim e bën me kujdesin më të madh, duke gjetur emra vendesh e toponimesh, duke shpjeguar origjinën e tyre, duke e zhveshur kështu letërsinë e De Radës nga elementi fiktiv dhe duke e veshur me elemente reale jetësore.

Meqenëse Pipa pjesën më të madhe të studimit që i bën letërsisë arbëreshe e orienton kah De Rada, kjo edhe mund të nënkuptojë se, nëse De Rada është përfaqësuesi i letërsisë arbëreshe, atëherë rrjedhimisht mendimi i Pipës mbi letërsinë e tij është njëkohësisht mendim mbi një periudhë të tërë letrare.

Teoritë letrare sociologjike - nga Herderi e deri tek Escarpi - ofruan shumë argumente mbi ndikimet shoqërore në letërsi, aso që u shoqëruan me emërtime të ndryshme. Mbi këto parime Pipa ofron emërtimet origji-nale në orvatjen për argumentimin e kësaj teorie: *Ethosi* dhe *Ethnosi*, dy kategori të reja në qasjen sociologjike që zhvendosin kufijtë e formulës së Taines. Tejkufishmëria e traditës kulturore, fetare, etnike e gjuhësore që paraqet Pipa përmes shembullit të letërsisë arbëreshe e rikonfirmon bindjen e tij se letërsia është produkt shoqëror, por kufijtë e ndikimit e kalojnë moshën shoqërore e kulturore të artistëve krijues. Këtë bindje e shpreh me argumentin se letërsia arbëreshe bart shenja nacionale, por edhe shenja të veçanta kulturore të hapësirës gjeografike prej nga u zhvendosën arbëreshët në Itali. Madje këto shenja tejkalojnë kufijtë etni-kë shqiptarë - në rastin kur provon të gjejë shenjat e simbiozës shqiptare dhe arumune, shenjat e kulturës popullore, shenjat e kulturës ndëretnike si diktat historik e gjeografik. Nga modeli i paraqitjes së letërsisë artistike si reflektim i etnogjenezës, Pipa ndërton modelin tipologjik të letërsisë shqipe, e njëkohësisht ndërton historikun e kësaj tipologjie - një model krejt i veçantë e i ndryshëm nga sa mund të vërehet qoftë në studimet let-rare shqiptare në fushë të kritikës, qoftë në fushë të historisë së letërsisë.

Barinj dhe Katundarë në Letërsinë Shqipe është studim tematik e formal i letërsisë shqipe. Literarisht i kuptueshëm kur merren në konsi-deratë argumentimet e Pipës mbi veçantitë letrare që e dominojnë letër-

sinë shqipe, e cila vetëm kur është e lidhur me viset malore mbetet burim i *ethosit* shqiptar. Për Pipën, letërsia shqipe shkruhet jo si krijimtari artistike për efekte estetike, po për efekte politike. Këtë ide e konkretizon me shembullin e poezisë së Naimit, *Bagëti e Bujqësia*, i cili u këndon maleve të Shqipërisë për t'i lartësuar ato nga frika e pushtimit grek. Pra, letërsia e Naimit për Pipën është *strategji për dalje nga situata*, nëse mund të flasim me konceptet e Keneth Burkeit.

Duke ndërtuar historinë dhe tipologjinë e zhvillimit të letërsisë shqipe, Pipa burim parësor të letërsisë artistike shqiptare në përgjithësi e sheh letërsinë popullore: *Një anë dalluese e letërsisë shqipe është lidhja e saj e ngushtë me folklorin... shumë poetë romantikë, duke përfshirë këtu edhe me përfaqësuesit, Frashërin dhe Fishtën, kanë shkruar vepra që zhvillojnë tema të poezisë gojore dhe të traditës, duke u mbështetur fort mbi modelet stilistikore folklorike, përfshirë këtu edhe metriken folklorike.*²⁶

Dhe nëse ekziston një diferencë sado e vogël formale, ideore e tematike apo edhe stilistikore e metrike mes letërsisë popullore dhe asaj artistike, për Pipën është rezultat i kushteve shoqërore. Kjo argumentohet edhe me tipologjinë e letërsisë shqipe të pas viteve 1940, që Pipa e trajton te kapitulli *Fshatari në letërsinë bashkëkohore*. Edhe pse distanca prej fazës së përngjasimit të letërsisë artistike me letërsinë popullore deri te tentimi për krijimtari artistike me premisa estetike ishte e madhe, letërsia shqipe nuk arriti të shkëputej si mendësi e tematikë as nga letërsia popullore, as nga jeta shoqërore e kohës. Dëshmia e Pipës për ekskluzivitetin e letërsisë shqipe si produkt shoqëror na rikujton mendimin e Eqrem Çabejit se *çelësi për njohjen e letërsisë së një kombi është njohja e historisë së atij kombi*²⁷. Ndaj, njohja e letërsisë shqipe për Pipën bëhet përmes derës së historisë e sociologjisë shqiptare dhe anasjelltas. Kjo dëshmohet lehtë edhe kur Pipa trajton veprën e Gjergj Fishtës. Sipas Pipës, origjina, shkollimi, veprimtaria jetësore e Fishtës dhe çdo gjë që ka ndikuar e ndihmuar në formimin e tij, është e reflektuar në veprën e tij letrare.

Për t'i përligjur emërtimet e kapitujve *Fshatari në letërsinë bashkëkohore* dhe *Barinj dhe Katundarë në Letërsinë Shqipe*, Pipa kur flet për autorët e njohur të letërsisë shqipe, bën një parantezë të shkurtër biografike, me theks të veçantë mbi vendlindjet e tyre, pasi ata kryesisht

²⁶ Arshi Pipa, *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Princi, Tiranë 2013, f. 85.

²⁷ Eqrem Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, "Hylli i Dritës", Shkodër 1939, f. 5.

janë bij fshatrash, ose të dalë nga familje fshatarësh, çka lë të kuptohet se, sipas Pipës, jo vetëm njeriun e bën ambienti, por gjithashtu edhe produktivitetin artistik.

Përpos pasqyrës së përgjithshme mbi ndikimet sociologjike në letërsinë shqipe, Pipa në studimin mbi Migjenin, me titull *Miti i perëndimit në poezinë e Migjenit*, e sjell në praktikë kritikën sociologjike si qasje studimore letrare. Për Pipën, shembulli tipik i letërsisë sociologjike si krijim letrar dhe si fuqi ndikuese *post scriptum* është letërsia e Migjenit. Përpos gjetjes së elementit të origjinës të Migjeni, element që interferon hapur në gjuhën dhe formën e poezisë së tij, insistohet edhe në gjetjen e *kohës* dhe *vendit*, si parakushte që ndikuan në natyrën e poezisë të ky autor. Këto dy elemente e diktuan lakoren nëpër të cilën lëvizën poezitë migjeniane, lakore e cila, me gjithë harkimet tematike, formale e ideore, Migjenit ia mundësoi vulën e origjinalitetit si poet *dekadent* e *revolucionar*. Letërsia e Migjenit, sipas Pipës, u shfaq si rezultat i *impulseve të fituara nga situatat konkrete të jetës së tij*, letërsi që paraqet shembullin tipik se si arti letrar bashkëjeton me “shqetësimet” shoqërore dhe rikthehet te kjo e fundit si dëshmi e brengës paternale ndaj atyre shqetësimeve, duke provuar kështu se letërsia e Migjenit është krijuar për konsum të gjerë shoqëror, jo si përvojë estetike, por si nevojë për “kryengritje”.

Te *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Pipa operon mes disiplinash shkencore letrare, mes historisë së letërsisë dhe kritikës letrare. Por, gjithsesi, ky degëzim të Pipa është i shpërfaqur si teori, kritikë e histori e letërsisë (kjo e fundit shfaqet në kapitullin *Periodizimi i letërsisë shqipe*, periodizim i mbështetur mbi kriteret sociologjike).

Koha e shkrimit të këtyre eseve përkon me kohën kur në Shqipëri kritika letrare i ishte nënshtruar kritikës soc-realiste, e në Kosovë bashkëjetonte në hap me metodat e kritikës moderne. Distanca emocionale e ideologjike që Pipa kishte me vendlindjen e tij dhe mundësia për njohjen e zhvillimeve të kritikës letrare të kohës e diktoi, siç duket, edhe leximin e veçantë që ky kritik ia bëri letërsisë shqipe. Kështu, konstatimi i Thomas Eliotit se *çdo gjeneratë duhet ta sjellë kritikën e vet letrare*²⁸ duket se nuk u rri për shtati zhvillimeve të kritikës letrare shqipe. Megjithatë, në gjithë studimin që Pipa ia bën letërsisë shqipe të *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, ka mjaftueshëm argumente për të besuar se ky autor e shkruan kritikën për të huajt. Vetëdija se lexuesit e parë të këtyre

²⁸ Thomas Stearns Eliot, *Ese të zgjedhura*, Rilindja, Prishtinë 1982, f. 38.

studimeve janë lexues të huaj ka bërë që Pipa të kujdeset që të japë shpjegime të hollësishme në rastet kur flet për shenja autentike shqiptare (p.sh. *lahuta është një instrument muzikor tradicional*²⁹, ose *kur një kongres kombëtar gjuhësor*³⁰ ..., ose edhe shpjegimet e hollësishme për shallin e rugovasve.³¹)

Në këtë mënyrë, Pipa shpreh *vetëdijen letrare* përmes *dëshmisë letrare*³², vetëdije e dëshmi që për lexuesin e huaj mund të shërbejnë si informacion për një kulturë e letërsi të panjohur, por për lexuesin shqiptar kjo mbetet vetëdije dhe dëshmi që, përmes historisë, shoqërisë e kulturës, të shpaloset vetëm një nga udhët e shumta që çojnë në njohjen e artit letrar. Ideja që teksti i dedikohet publikut të huaj i arsyeton edhe emërtimet mbi tipologjinë e letërsisë shqipe. Nëse shprehjet *fshatare* dhe *katundare* në letërsinë shqipe për ambientin kulturor shqiptar mund të tingëllojnë si pezhorative, për publikun e huaj, i cili nuk jeton me *kompleksin e ambientit*, këto cilësime janë shumë të natyrshme.

Përfundim

Elementet referenciale që e shënjojnë kritikën letrare shqipe, të shfaqura në fillim të këtij punimi, shërbejnë vetëm si një parahyrje për ta kuptuar arsyen pse Arshi Pipa veçohet nga kritikët e tjerë që kanë shkruar për letërsinë shqipe. Kjo veçanti pasqyrohet qartë kur e krahasojmë atë me modelet nga shkolla sociologjike letrare, shkollë e cila ka pasur një shtrirje të gjerë në studimet letrare në përgjithësi, por që në letërsinë tonë markohet me studimet letrare të Arshi Pipës.

Qasjen sociologjike karshi letërsisë shqipe Pipa e bën të dukshme duke ofruar që në titull metodën e tij të studimit, të cilën preferon ta quajë *perspektivë*. Pavarësisht kësaj, Pipa këmbëngul që letërsia shqipe të bëhet e kuptueshme vetëm duke e njohur trajektoren e zhvillimeve shoqërore shqiptare. Dhe pikërisht këtu hetojmë se si i ndan Pipa formacionet letrare dhe cilat attribute shoqërore ia vendos një periudhe të veçantë, një autori apo një faze specifike të letërsisë shqipe. Kjo gjë tregon më së miri se, për Pipën, letërsia e Rilindjes e krijuar tek arbëreshët, është për-

²⁹ Arshi Pipa, *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Princi, Tiranë 2013, f. 139.

³⁰ Po aty, f. 120.

³¹ Po aty, f. 171.

³² Për konceptet '*vetëdija letrare*' dhe '*dëshmia letrare*', shih Thomas Stearns Eliot, vepër e cituar, f. 22.

kthim në shkronja i shpirtit shqiptar, qoftë si linjë fetare e filozofike, qoftë si linjë e traditës, sikundër që vë në pah faktin se si në një pjesë të madhe të letërsisë shqipe hetohen shenjat rurale e baritore dhe rastin kur letërsia transformohet nga kjo linjë e jetës së thjeshtë në një perspektivë tepër intime personale ndaj botës, e shprehur në formë estetike, konkretisht me Migjenin, autor ky i cili është më meritori për vënien në dritë të shkollës tipike sociologjike nga ana e Pipës.

Literatura

Adams, Hazard dhe Searle, Leroy. *Critical Theory since Plato*. Pekin: Peking University Press, 2006.

Burke, Keneth. "Literature as Equipment for Living" në *Critical Theory Since Plato*. Pekin: Peking University Press, 2006.

Çabej, Eqrem. *Për gjenezën e literaturës shqipe*. Shkodër : Hylli i Dritës, 1939.

Dobie, Ann B. *Theory into practice : an introduction to literary criticism*. Australia : Thomson, Wadsworth, 2002.

Eliot, Thomas Stearns. *Ese të zgjedhura*. Prishtinë: Rilindja, 1982.

Hamiti, Sabri. *Kritika letrare (Vepra letrare 6)*. Prishtinë: Shtëpia Botuese Faik Konica, 2002.

Ismajli, Rexhep. "Arshi Pipa: Ftesë për lexim", MM: revistë mikste teorike dhe letrare, nr. 6-7. (1997), fq. 170-176.

Jadhav, Arun Murlidhar. "The Historical Development of the Sociological Approach to the Study of Literature", International Journal of Innovative Research & Development. Issue 5. (2014), 658-662.

<http://www.internationaljournalcorner.com>

Laurenson, Diana T. dhe Swingewood, Alan. *The sociology of literature*. New York: Schocken Book, 1972.

Lowenthal, Leo. *Literature and the image of man*. Boston: Beacon Press, 1957.

Maloki, Krist: *Refleksione : kritikë (letrare), analiza dhe mendime*. Prishtinë: Shtëpia Botuese Faik Konica, 2005.

Pipa, Arshi. *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*. Tiranë: Princi, 2013.

Rugova, Ibrahim dhe Hamiti, Sabri. *Kritika letrare: tekste, shënime, komente*. Prishtinë: Rilindja, 1979.

Rugova, Ibrahim: *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare: 1504-1983*. Prishtinë: Shtëpia Botuese Faik Konica, 2005.

Shala, Kujtim M. *Zbulesa e Modernitetit (Ontos-i, poetika e kritika)*. Prishtinë: Fondacioni Ibrahim Rugova, 2017.

Shehri, Dhurata. *Statusi i kritikës*. Tiranë : Albas, 2013.

Wellek, Rene. *A history of modern criticism: 1750-1950*. New Haven and London: Yale University Press, 1965.

CRITICAL AWARENESS OF ARSHI PIPA

Summary

The referential elements that marks the Albanian literary criticism, shown at the beginning of this paper, indeed serve only as an introduction to understand why Arshi Pipa differ from other critics who have written about Albanian literature. This particularity is clearly reflected when we compare him with the models from the literary sociological school, a school which has had a wide range in literary studies in general, but which in our literature is marked with the literary studies of Arshi Pipa.

Pipa makes the sociological approach to Albanian literature obvious by offering in the title his method of study, which he prefers to call perspective. Despite this, Pipa insists that Albanian literature can be understood only by recognizing the trajectory of Albanian social developments. And precisely here we see how Pipa divides literary formations and what social attributes he assigns to a particular period, to an author or to a specific phase of Albanian literature. This best shows that for Pipa, the literature of the Renaissance created by the Arbëresh is a literal translation of the Albanian soul, whether as a religious and philosophical line, or as a line of tradition. He also highlights the fact that in a large part of Albanian literature rural and pastoral signs are detected and, besides this, Pipa shows us the case when literature is transformed from this line of simple life into a very intimate personal perspective on the world expressed in aesthetic form, specifically with Migjen, the author who is most deserving of enlightening the school typical sociological of Pipa.

III. KRITIKA DHE RECENSIONE

